



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET –ÇOHU

# RAPORTI I PUNËS 2014



## HISTORIKU I ORGANIZATËS

**E**themeluar në shtator të vitit 2005, qëllimi i Organizatës Çohu është kufizimi i ndikimit të korrupsionit politik në institucionet publike të Kosovës. Përderisa Kosova mbetet një vend i varfër dhe i pazhvilluar, me rritje të ulët ekonomike, korrupsioni duket të ketë marrë një kahje tjetër, atë të zgjerimit. Për ta zvogëluar korrupsionin dhe për ta hapur rrugën për zhvillim, Çohu angazhohet për institucione transparente dhe llogaridhënëse. Në kuadër të aktiviteteve të saj, Çohu i monitoron rastet e dyshuara të korrupsionit në gjykatat e Kosovës, monitoron dhe raporton mbi parashkrimin e lëndëve të korrupsionit, rishikon dhe propozon ndryshime të infrastrukturës ligjore dhe institucionale kundër korrupsionit. Këto aktivitete kryhen nga Zyra Ligjore dhe Kundër korrupsion e Çohut. Rishikimi dhe analizimi i kontratave të prokurimit publik është aktivitet në të cilin organizata është specializuar dhe ka zhvilluar metodologji të veten hulumtuese duke gjeneruar kështu të dhëna të rëndësishme mbi shpenzimet publike. Për të nxitur hulumtimin dhe për të arritur tek audiencia më të gjera, Organizata Çohu ka themeluar krahun e saj gazetaresk, Qendrën Kosovare për Gazetari Hulumtuese (QKGH) e cila e publikon revistën “Preportr”. Përmes aplikimit të metodologjisë së zhvilluar, “Preportr” ka publikuar hulumtime jetike mbi patronazhin politik, klientelizmin, prokurimin publik, energjinë, shëndetësinë, arsimin e lartë, kompanitë publike si PTK, KEK dhe ANP, apo mbi kontratat investuese të ashtuquajtura “strategjike” me vlerë të lartë monetare siç është “Rruga e kombit”.

Me rritjen e punës sonë, po rritemi edhe ne. Jemi gjithmonë në kërkim të vendeve të reja, të territoreve të reja për eksplorim dhe të fushave të reja për hulumtim. Lëvizja në drejtim të fushës së “të dhënave të hapura” (Open Data), që t’i eksplorojmë ato dhe t’i shndërrojmë në mjet për arritjen e një transparence dhe llogaridhënieje më të lartë të institucioneve publike, është, mes tjerash, një nga qëllimet e Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe Demokratizim. Teknologjitë e reja ua mundësojnë organizatave të shoqërisë civile që të jenë më efikase dhe të arrijnë tek një publik më i gjerë. Duke qenë në mes të një organizate mbikëqyrëse (watchdog) dhe të një organizate hulumtuese (think-tank), Çohu nuk vendos kufij sa i përket përdorimit të metodave të ndryshme për të arritur synimet e saj të krijimit të institucioneve transparente, llogaridhënëse dhe demokratike.



## ORGANOGRAMI DHE ZYRAT

Organizata ÇOHU! është e regjistruar si fondacion në Zyrën për Regjistrimin e Organizatave të Shoqërisë Civile pranë Ministrisë së Administratës Publike. Duke poseduar statusin juridik të fondacionit, ÇOHU! mbikëqyret nga Bordi i organizatës, i cili është edhe organi më i lartë vendim-marrës.

### Qendra Kosovare për Gazetarë Hulumtues

Duke parë mungesën e investimit të mediave kosovare në gazetarinë hulumtuese dhe të pavarur, ÇOHU! ka themeluar një qendër për raportim hulumtues dhe për përkrahjen e gazetarëve hulumtues. Qendra Kosovare për Gazetarë Hulumtues (Kosovo Centre for Investigative Journalism – KCIJ) bashkëpunon në baza të rregullta me dhjetëra gazetarë, kurse punon aktivisht me rreth dhjetë prej tyre në hulumtimin e temave sidomos në fushën ekonomike dhe tema që kanë lidhshmëri me menaxhimin e kompanive publike. KCIJ boton një shtojcë të përdymuajshme në dy gazetatat më të mëdha ditore, gjegjësisht në “Koha ditore” dhe në “Zëri”. Poashtu, kjo qendër boton një lloj shumë specifik të një magazine online me raporte hulumtuese dhe me pikëvështrime alternative mbi sferën publike përgjithësisht dhe në fushën ekonomike veçanërisht ([www.preportr.com](http://www.preportr.com)). Kjo qendër ka një bashkëpunim intensiv me qendra të ngjashme në rajon sidomos me Qendrën Rumune për Gazetarë Hulumtues, e njohur si një nga qendrat më të suksesshme në Evropën Juglindore.

### Zyra për Demokratizim dhe Integritet Publik

Zyra për Demokratizim dhe Integritet Publik ka si fushëveprimtari monitorimin e punës së qeverisë dhe projekteve me rendësi për vendin. Kjo zyre fillimisht është marrë me monitorimin e punës së Qeverisë në çdo 100 ditë punë duke analizuar proceset me rendësi në periudha të ndryshme kohore. Ky departament së fundmi është marrë me monitorimin e tenderëve në ministritë me buxhet më të madh me rast është krijuar databaza e Organizatës me të dhënat përkatëse. Nga kjo Organizata publikon raporte analitike rreth shpenzimit të parasë publike, duke analizuar bizneset dhe rajonet të favorizuara, si dhe ndikimin politik në vetë shpenzimin e parasë publike.




ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET –ÇOHU

ZYRA E KËSHILLTARIT LIGJOR DHE INFRASTRUKTURË ANTI-KOKORRUPSION

Nëpërmjet Zyrës së Këshilltarit Ligjor dhe të Monitorimit të Legjislacionit Antikorrupsion Organizata ÇOHU! është një pjesëmarrëse e përhershme në grupet punuese për përpilimin e ligjeve. Përveç pjesëmarrjes në grupet punuese me Kuvendin e Kosovës dhe institucionet tjera, jo rrallë ÇOHU! kërkon bashkëpunim me organizata tjera në ekspozimin e pikave të dobëta të identifikuara në legjislacionet ekzistuese dhe ato që janë në përgatitje e sipër. Pjesë e rëndësishme e kësaj zyre është edhe kontakti me palët që kanë informacione dhe dokumente për të denoncuar, të cilat Zyra e këshilltarit ligjor i analizon dhe i raporton në Zyrën e Prokurorit Special, apo edhe në zyra tjera në varësi të rastit..



## Organogrami





## PËMBLEDHJA E AKTIVITETEVE 2014

### ORGANIZATA ÇOHU!

#### Analizë politikash

Gjatë vitit 2014 Çohu! realizoi një sërë aktivitete në fushën e analizave politike, avokimit dhe aktiviteteve wach dog. Fokusi i organizatës në analiza polirike ishte a) Konflikti i interesit, b) Deklarimi i pasurisë dhe c) Konfiskimi i pasurisë.

Sa i përket aktiviteteve në avokim dhe wach dog fokusi i organizatps ishte në a) Parashkrimi i lëndëve penale, b) transparenca lidhur me nënshkrimin e kontratës nga qeveria lidhur me ndërtimin e autostradës.

- Konflikti i interesit

Drafti i parë i analizës mbi konfliktin e interesit ka përfunduar. Kjo analizë ka për synim jo vetem ekzaminimi i ligjeve por edhe impaktin e tyre përmes studimit të vendimeve të Agjencionit Antikorrupsion për çështjet e konfliktit të interesit nga viti 2001- 2014. Përmëtepër Çohu ka bërë një analizë të gjigjeve, duke e krahasuar me praktikën më të mira në mbarë botën, si dhe ka analizuar rreth 308 vendime të konfliktit të interesit të marra nga Agjensioni Antikorrupsion.

- Konfiskimi i pasurisë

Falë ndryshimeve në ligjin mbi konfiskimin e pasurisë, Çohu nga ndërmarrë një iniciativë për analizimin e ligjit të ri mbi shtimin e kompetencave në konfiskimin e pasurisë së fituar përmes aktiviteteve kriminale. Qëllimi ynë është a) të ofrojmë një analizë gjithëpërfshirëse mbi ndryshimet e reja në ligj, b) të vlerësojmë progresin si dhe c) të masim impaktin e tij në konfiskimin e pasurisë.

- Parashkrimi i lëndëve penale

Çohu në vitin 2014 ka vazhduar aktivitetin lidhur me parashkrimin e lëndëve penale. Gjatë muajit janar Çohu publikoi raportin e tretë me radhë monitorues mbi parashkrimin e lëndëve penale. Gjatë muajit korrik u organizua edhe një tryezë për diskutim rreth problemit të parashkrimit të lëndëve dhe si mundësi e rithimit të kësaj problematike në diskutim publik.



## AVOKIMI DHE AKTIVITETET WATCHDOG

### Aktivitetet avokuese

- Parashkrimi i lëndëve penale

Në gjysmën e parë të vitit, Çohu ishte në kontakt të vazhdueshëm me dy nga institucionet gjyqësore më të rëndësishme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit Diciplinor, si dy institucionet përgjegjëse për trajtimin e çështjes së parashkrimit të lëndëve penale. Qëllimi ynë primar është avokimi dhe inkurajimi për një rol më proaktiv sa i përket parashkrimit të lëndëve, me fokus të veçantë në: a) avokimin tek KGJK për futjen e të dhënave të parrashkrimit në raportin e tyre vjetor, b) shtyerja e Zyrës së prokurorit Diciplinor në ndërmarrjen e hetimit zyrtar të gjyqtarëve përgjegjës për parashkrimin e lëndëve.

### Aktivitetet watchdog

- Deklarimi i pasurisë

Çohu ka reaguar rreth mospublikimit të regjistrave të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë gjatë zgjedhjeve nacionale, nga ana e Agjencionit Antikorrupsion. Si rezultat Agjencioni Antikorrupsion ka bërë shkelje ligjit dhe shkelje të praktikave pararake sic parashihen me anë të ligjit për deklarimin e pasurisë. Pas reagimit tonë të parë Agjencioni nuk është përgjigjur fare, mirëpo duke parë që Agjencioni nuk ka për qëllim publikimin e regjistrave të deklarimit të pasurisë ne kemi kërkuar edhe një herë bërjen publike të këtyre regjistrave para zgjedhjeve nacionale sic parashihen edhe me anë të ligjit. Pas këtij regaimi të dytë agjencioni Antikorrupsion ka reaguar vrullshëm duke e cilësuar Organizatën Çohu si “organizatë politike”. Në bazë të gjuhës së përdorur vihet në pah fare kjo paragjykim i rolit të organizatave si dhe standardet e dyfishta në realizimin e aktiviteteve të këtij Agjencioni. Përkundër shkrimeve në media Agjencioni nuk kishte dhënë kurrëfarë përgjigje.

- Kontrata për ndërtimin e autostradës së re

Pas përcjelljes së aktit të nënshkrimit të kontratës për ndërtimin e autostradës (Prishtinë-Hani i Elezit) nga ana e qeverisë, Organizata Çohu reagoi publikisht duke theksuar mungesën e transparencës si dhe mungesën e argumentimit sa i përket qëndrueshmërisë ekonomike.



## QENDRA KOSOVARE PËR GAZETARI HULUMTUESE – QKGH

Gjatë vitit 2014 KCIJ ka publikuar 3 numra të gazetës Preportr si dhe ka realizuar duku rreth nëntë shkrime hulumtuese. Gjatë kësaj periudhe poashtu janë realizuar edhe foto storie dhe video si shoqëruese të hulumtimeve të lartpërmendura.

1. Preportr - Ambienti - në pjesën e parë të vitit u realizua hulumtimet për ndotjen e lumenjëve dhe ai për keqmenxhimin e deponive të mbeturinave. Këto hulumtime u shoqëruan edhe me foto storie si dhe me video përkatëse.<sup>1</sup>
2. Preportr –Patronazhi politik - në pjesën e dytë të vitit u realizua hulumtimi për patronazhin politik dhe prezencën e tij në institucionet e Kosovës<sup>2</sup>
3. Preportr – Citokontrabanda – ky hulumtim u realizua gjatë katërmujorit të fundit të vitin dhe u publikua në Janar 2015. Ky hulumtim rrëfen mbi keqpërdorimet dhe rrjetin e kontrabandës me medikamente, veçanërit me citostatikë si medikamente të domosdoshme dhe me çmim shumë të lartë.<sup>3</sup>

QKGH për çdo vit organizon një trajnim në fushën e gazetarisë hulumtuese. Trajnimi në vitin 2014 u fokusua në tri aspekte të ndryshme: **a)** metodologjia dhe mjetet në gazetarinë hulumtuese; **b)** përdorimi i teknologjisë (foto, video dhe editimi) dhe **c)** etika dhe të drejtat e njeriut në gazetarinë hulumtuese. Trajnimi kryesisht fokusohet në aspekte të praktikës në gazetarinë hulumtuese, duke mos anashkaluar edhe teorinë. Si i tillë, projekti ka ardhur si domosdoshmëri duke qenë se Universiteti Publik, por edhe fakultetet private, nuk e kanë të zhvilluar aspak praktikën në gazetarinë hulumtuese.

Trajnimi ka në fokus kryesisht studentë të gazetarisë, duke mos anashkaluar edhe të interesuarit e tjerë. Gjatë këtij viti trajnimin e ndoqën 7 studentë.

---

<sup>1</sup> [file:///C:/Users/Flor/Desktop/preportr\\_09\\_alb\\_910328.pdf](file:///C:/Users/Flor/Desktop/preportr_09_alb_910328.pdf)

<sup>2</sup> [http://preportr.com/repository/docs/Preportr\\_10\\_alb\\_924124.pdf](http://preportr.com/repository/docs/Preportr_10_alb_924124.pdf)

<sup>3</sup> [http://preportr.com/repository/docs/Preportr11-web\\_964263.pdf](http://preportr.com/repository/docs/Preportr11-web_964263.pdf)





# TË ARRITURAT PËR VITIN 2014

## ORGANIZATA ÇOHU

Lëndët me parashkrim po trajtohen me më shumë kujdes nga ana e Zyrës së Prokurorit Diciplinor (ZPD).

Gjatë vitit 2014 ZPD ka nisur hetimet për 64 gjyqtarë dhe prokurorë lidhur me parashkrimin e lëndëve penale.

Gjykatat poashtu kanë marrë disa masa për adresimin e çështjes së parashkrimit. Gjatë vitit 2014 ka një rënie prej 4% të parashkrimit të lëndëve krahasuar me vitin paraparak, një trend ky mjaft pozitiv krahasuar me trendin në rritje nga viti 2011.

Prokuroritë gjithashtu kanë marrë masa në shqyrtimin e lëndëve të korrupsionit. Afër 45% e lëndëve janë shqyrtuar nga prokuroritë dhe ky total për rreth 30% të tyre janë ngritur edhe aktakuza.

Një e arritur tjetër vërehet edhe me rastin e përmirësimeve pozitive në Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, ku si rezultat në vitin 2014 vetëm dy zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë, përdërisa në vitin 2013 numri i zyrtarëve që nuk deklaruan pasurinë ishte 35, ndërsa në vitin 2012 ky numër ishte 261.

E arritur tjetër jatë këtij viti poashtu mund të konsiderohet edhe harmonizimi i Ligjit për Deklarimin e Pasurisë me Kodin Penal, pasi që gjerë tani kjo mungesë harmonizimi është shfrytëzuar nga institucionet si pretekst për ti ikur detyrimeve të caktuara të përcaktuara me ligj.

E një rëndësie mjaft të madhe mbete edhe rritja e transparencës së Zyrës së Prokurorit Diciplinor. ZPD vazhdimisht informon për hetimet që ka nisur mbi bazën e hulumtimeve dhe raporteve të Çohut.

Në vitin 2014<sup>4</sup>, ZPD ka hapur në 17<sup>5</sup> raste hetim disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve (10 gjyqtar dhe 7 prokuror) për sjellje të mundshme të pahijshme për shkak se, si rezultat e mos veprimeve (neglizhencës) në punë kanë lejuar parashkrimin (vjetërsimin) e veprave penale dhe sanksioneve penale.


<sup>4</sup> 53 lëndë të vitit 2014, kanë filluar të hetohen në janar të vitit 2014, për këtë arsye këto lëndë janë referuar në raportin narrativë të vitit 2013.

<sup>5</sup> Nga totali prej 18 lëndëve të vitit 2013, 6 lëndë janë hetuar gjatë viti 2013, mirëpo kanë përfunduar në vitin 2014.

Nga 17 rastet e hapura disiplinore, 8 raste ZPD i ka dërguar për procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor të KGJK-së dhe KPK-së. Në 9 rastet tjera procedura disiplinore është duke vazhduar.

Në raste ku ZPD ka rekomanduar procedurën disiplinore, Komisionet kanë shqiptuar masat disiplinore: Qortim, Qortim me udhëzimin e masave korrigjuese dhe ulje e përkohshme e pagës deri në 50 %.

### Zyra e Prokurorit Disiplinor Parashkrimi 2013/15





## QENDRA KOSOVARE PËR GAZETARI HULUMTUESE - QKGH

Aktivitetet e QKGH-së gjatë këtij viti kanë ndikuar dukshëm në zhvillimin e mëtutjeshëm të kësaj qendre. Gjatë këtij viti kjo qendër ka angazhuar edhe dy gazetarë me orar të plotë, që të dy pjesëmarrës në Shkollën për Gazetari Hulumtuese të cilën e organizon QKGH. Ky vit poashtu u karakterizua edhe me zhvillim të mëtutjeshëm të metodologjisë hulumtuese si dhe me paisje shtesë të teknologjisë që kjo qendër ka në shfrytëzim.

- Gazeta Preportr – Ambienti

Përmëtepër, publikimi i shtojcës për ambientin e cila trajton gjendjen e lumenjëve dhe deponive të mbeturinave në Kosovë, përveç që ka hedhur dritë mbi dy çështje mjaft të rëndësishme, poashtu ka trasuar edhe rrugën për hulumtimet e ardhshme më të detajuara në këtë fushë, që njëherit është përfshirë në *Planin e Punës 2015*.

Ky hulumtim u ripublikua nga 13 online media.

- Gazeta Preportr – Patronzhi

Publikimi i hulumtimit mbi patronazhin politik në institucionet e Kosovës u vlerësua mjaftë lartë nga profesionistë të fushës, pasi që në Kosovë asnjëherë gjer më tani nuk u paraqit një hulumtim i cili bazuar në të dhëna të hulumtuara ofroi analizën konkrete të shtrirjes së patronazhit politik në institucionet e Kosovës. Ky hulumtim poashtu u publikua në shumë portale të tjera.

Ky hulumtim u ripublikua nga 19 online media të ndryshme.

- Gazeta Preportr – Citokontrabanda

Përmes këtij hulumtimi preportr arriti që të vë dritë mbi kontrabandën e citostatikëve në Kosovë, terapi kjo për trajtimin e sëmundjeve të kancerit. Preportr arriti që të paraqesë se me sa lehtësi mund të hasësh në treg citostatikë të kontrabanduar dhe atë në barandoret pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Përveç që rrjeti i kontrabandës funksiononte me shumë lehtësi, të gjithë këta citostatikë të kontrabanduar përfundonin në Klinikën e Onkologjisë dhe pacientët trajtoheshin me ta. Kjo klinikë pa asnjë bazë ligjore detyronte pacientët të nënshkruajnë një dokument i cili e vë pacientin përballë përgjegjësisë në rast të efekteve anësore nga trajtimi me citostatikë të dyshimtë. Ky publikim pati një ndikim të madh si dhe pati mbulueshmëri të madhe nga mediat e vendit. Nga të gjeturat e këtij hulumtimi, organizata Çohu! ngriti edhe një padi lidhur me këto shkelje. Portale të shumta publikuan të gjeturat e këtij hulumtimi.



## ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET –ÇOHU

Ky hulumentim u ripublikua nga 12 online media si dhe u prezentua edhe në televizionet vendore.

- Foto dhe video gazetaria

QKGH përmes trajnimit në fushën e foto dhe video gazetarisë ka arritur që thuaja secilin hulumentim ta paraqes edhe përmes foto dhe video reportazheve.

- Shkolla për Gazetari Hulumtuese


Nga fundi i vitit 2014, përkatësisht 3 muajt e fundit të vitit, u mbajt edhe sezoni i katërt i trajnimit mbi gazetarinë hulumtuese. Ky trajnim rezultoi mjaft i suksesshem dhe u vlerësua mjaft lartë edhe nga vetë studentët pjesëmarrës. Si rezultat tanime të gjithë pjesëmarrësit janë të angazhuar në hulumtime të ndarë në 4 grupe. Publikimi i këtyre hulumtimeve do të jetë në majin maj 2015.

**Të dhënat mbi vizitën e portalit Preportr**


Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2014 web-site i Preportr ka pasur 287,423 vizita, kur prej tyre 81,684 apo 28.4% kanë qenë vizitor të rinj, ndërsa 205,739 apo 71.6% kanë vizituar Preportr.com më shumë se një herë.

Numri i përgjithshëm i vizitave në web-site, në krahasim me vitin paraprak, është rritur për 67.59%.

Nga totali i vizitorëve që më së shumti vizituan webin 258,216 apo (89.84%) e vizitorëve janë nga Kosova , 5,020 (1.75%) nga Serbia, 3,742 (1.30%) nga Shqipëria dhe 11,683 (4.07%) e vizitorëve janë nga vende të ndryshme.



Ripublikimi i gazetës Preportr në mediat tjera



Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

